Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	**28.12.2023**	**05.01.2024**	**2023/1018**
Eksperti Teknik **Merita Mehmeti**	Data e autorizimit të ekspertit teknik **29.12.2023**		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 15.12.2023, **OE "Alkaloid"**, ka parashtruar ankesë me nr**: 2023/1018,** kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "F**urnizim me material per Hemodialize nga LE per SHSKUK**" LOT 1 dhe 3 me nr. të prokurimit: "**00220-23-12480-1-1-1**", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **LOT 1- 216,138.00 € dhe LOT 3- 2,034,350.00€**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Nenin 7 — Barazia në Trajtim/ Jo — Diskriminimi; pasi qe specifikimet teknike ne dosjen e tenderit jane diskriminuese konkretisht kerkesa per metoden e sterilizimit apo favorizimin e prodhuesve te cilet e perdorin metoden e sterilizimit me avull eshte diskriminimin per shume prodhues te njohur Boteror te cilet perdorin metoda te tjera te sterilizimit.

Neni 28- Specifikimet teknike

Ligji per Prokurim Publik ka percaktuar qe Dosja e Tenderit duhet te hartohet ne ate menyre qe te garantoje barazine ne trajtim dhe jo-diskriminim te Operatoreve Ekonomik te interesuar, duke nenkuptuar qe AK duhet te sigurohet qe te mundesoje sa me shume oferta nga OE te interesuar.

Tek Aneksi 1 ne DT - Specifikimet teknike te detyrueshme ne Lot 1 dhe Lot 3 keni pershkruar produktet qe pretendoni ti prokuroni duke cekur se produktet qe mund te ofrohen duhet te jeni "Steam Sterilisation" me Sterilizim me avull keshtu duke eliminuar te gjitha metodat tjera te sterilizimit sikur ato me sterilizim me Dry Heat, Gamma sterilizim dhe E-Beam Sterilizim, keshtu duke kufizuar konkurrencen dhe duke favorizuar vetem prodhues qe prodhojne Dializatore me Steam Sterilizaton e qe numri i tyre eshte shume i vogel ne krahasim me prodhues te njohur boterore per prodhimin e Dializatoreve me Sterilizim Gamma sic jane: B Braun, Nipro, Nikkiso, Asahi Kasy etj, keshtu duke shkelur Nenin 28 te LPP - Specifikimet Teknike.

Arsyetimi i AK-SHSKUK se per hartimin e specifikimeve teknike jane bazuar ne Listen Esenciale nuk qendrojne per arsyje se ky specifikim ne LE eshte qe nga viti 2003 dhe eshte i pershtatur specifikimeve te vetem nje kompanie Fresenius Medical Care e cila ka pasur monopol deri ne vitin 2017, kur pas ankesave eshte ndryshuar specifikimi teknik per Dializatore qe ka mundesuar pjesemarrje me te gjere te ofertuesve me prodhues te ndryshem me cfare edhe jane lidhur edhe kontrata me cmime shume me te ulta per sherbime te njejta.

Per te vertetuar qe AK-SHSKUK nuk i eshte referuar Listes Esenciale gjate perpunimit te DT ne te njejtat Lote koeficienti i i Ultrafiltrimit eshte kerkuar me e madhe ose e barabart me 40 per Lot 1 dhe me e madhe ose e barabart me 50 per Lot 3 gje qe nuk eshte ne perputhje me Listen Esenciale ku per produktin qe kerkohet per Lot 1 koeficienti i Ultrafiltrimit eshte 50 ndersa per Lot 3 ky koeficient ne LE eshte 55.

Gjithashtu specifikimi teknik i dy aktiviteteve te prokurimit te kaluara per produktet e njejta - Dializatore, nuk ne perputhje me specifikimin e LE me plote te drejte pasi si pasoje e kesaj ne keto dy aktivitete ka pasur se paku 4 ofertues, keshtu duke shtuar konkurencen dhe siguruar cmime me te uleta.(*bashkengjitur gjeni spcifikimin teknik te tendereve te kaluar*).

Shprehim shqetesimet tona se AK eshte duke perdorur standard te dyfishta s ai perket respektimit te Listes Esenciale, specifikimev teknike nga njesia kerkuese dhe ne Dojesn e Tenderit, duke pasur parasysh se ne vendimin e OSHP 370-401/19 nga i njejti AK jane shkelur Lista Esenciale, kerkesa e njesise kerkuese dhe specifikacioni teknik ne DT kinse per kursim te Buxhetit, ndersa ne kete rast insistohet te respektohen Lista Esenciale, kerkesa nga njesia kerkuese dhe specifikacioni teknik ne Dosje te Tenderit pavaresisht se lejimi i konkurences rezulton ne uljen e cmimit dhe kursimin e Buxhetit te SHtetit por ketu shihet se AK perdure standard te dyfishta per favorizimin e OE te preferuar vendos ne nje rast shkelje te Listes Esenciale dhe specifikacionit te DT ndersa ne rastin tjeter per respektim te LE dhe specifikacionit teknik te DT , dhe vetem insistohet te mbrohet sterilizimi me avull per te vetmin qellim favorizimin e OE te preferuar dhe mos lejimin e hapjes se konkurences per Operatoret tjere.

Kjo verteton qe AK-SHSKUK eshte duke perdorur standarde te dyfishta sa i perket

respektimit te Listes Esenciale , duke ju referuar kesaj Liste vetem kur deshirojne ta kufizojne konkurencen.

Ne te kunderten shtimi ne specifikim teknik edhe i Sterilizimit Gamma i regjistruar edhe ne EMA si sterilizim i barabarte me Sterilizimin me avull do te shtonte edhe me shume konkurencen, keshte duke shkelur **Nenin 7 te LPP - Barazia ne trajtim jo-diskriminim,** duke favorizuar prodhuesin me sterilizim me avull dhe duke diskriminuar prodhuesit e dializatoreve me Sterilizim Gamma. Studiues te njohur dhe ekspert te lemise kane vertetuar qe asnje mangesi, efekt anesore, problem apo dallim nuk eshte gjetur ne mes te Sterilizimit me avull dhe metodav tjera te sterilizimit gjegjesisht metodes Gamma.(*te bashkengjitur mund te gjeni letra shkencore nga EMA ne te cilen vertetohen qe sterilizimi me Gamma dhe metoda tjera te sterilizimit nuk paraqesin anje mangesi ne raport me metoden e sterilizimit me avull dhe se keto metoda jane metoda moderne te sterilizimit).*

Me tutje, materiali qe do te ofrohet, vjen i sterilizuar nga kompania prodhuese, qe ne kete rast mund te jene kompani me renome boterore, dhe nuk paraqet asnje rendesi nese eshte i sterilizuar me Steam apo Gamma.

Prandaj duke ju referuar te gjitha pretendimeve te cekura me lart, kerkojme qe lend ate kthehet ne Rivleresim dhe te behen ndryshimet e nevojshme te specifikimet teknike ne DT dhe te kursehet buxheti i shtetit.

KRITERET PËR VLERËSIM

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Lotet	**Produkti apo Pajisja Mjekësore** **Specifikimi (Forma/Fortësia, etj)**	Sasia për tender **Planifikimi për 24 muaj**	**Njësia Matëse**
Lot 1	**High flux Biocompatible Membrane - Haemodiafilter, steam sterilization Effective Surface area (m2) 1.6; Ultrafiltration Coeff (ml h - mmHg) me e madhe ose e barabart 40**	**26520**	**Copë**
Lot 3	**High flux Biocompatible Membrane - Haemodiafilter, steam sterilization Effective Surface area (m2) 1.8; Ultrafiltration Coeff (ml h - mmHg) me e madhe ose e barabart 50**	**176900**	**cope**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

N/A

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Alkaloid**

Aktiviteti i prokurimit: F**urnizim me material per Hemodialize nga LE per SHSKUK**" **LOT 1 dhe 3** me nr. të prokurimit: "**00220-23-12480-1-1-1**", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS, ka filluar me njoftimin për kontratë me datë 10.11.2023, për të cilin njoftim brenda afatit ligjor OE ankuesi parashtron kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, mirëpo pas refuzimit të kërkesës, atëherë me datë 22.12.2023 i njëjti parashtron ankesë në OSHP, duke pretenduar se AK kriteret në njoftimin për kontratë, përkatësisht LOT 1 dhe LOT 3 specifikimet teknike, janë diskriminuese dhe subjektive.**

OE ankuesi pretendon:

Njësia e kërkesës- Shkel Nenin 7 dhe 28 te LPP-se (Specifikime teknike favorizuese) Përpilimi i specifikimeve teknike te detyrueshme nga njësia e kërkesës për llot 1 artikujt LOT 1 dhe LOT 3, përkatësisht pretendimi i EO ankues citat:*" Tek Aneksi 1 ne DT - Specifikimet teknike te detyrueshme ne Lot 1 dhe Lot 3 keni përshkruar produktet qe pretendoni ti prokuroni duke*

cekur se produktet qe mund te ofrohen duhet te jeni "Steam Sterilisation" me Sterilizim me avull kështu duke eliminuar te gjitha metodat tjera te sterilizimit sikur ato me sterilizim me Dry Heat, Gamma sterilizim dhe E-Beam Sterilizim, keshtu duke kufizuar konkurrencen dhe duke favorizuar vetëm prodhues qe prodhojnë Dializatore me Steam Sterilizaton e qe numri i tyre eshte shume i vogël ne krahasim me prodhues te njohur botërore për prodhimin e Dializatoreve me Sterilizim Gamma sic jane: B Braun, Nipro, Nikkiso, Asahi Kasy etj, kështu duke shkelur Nenin 28 te LPP - Specifikimet Teknike.

Arsyetimi i AK-SHSKUK se për hartimin e specifikimeve teknike janë bazuar ne Listën Esenciale nuk qëndrojnë për arsyeje se ky specifikim ne LE është qe nga viti 2003 dhe është i përshtatur specifikimeve te vetëm një kompanie Fresenius Medical Care e cila ka pasur monopol deri ne vitin 2017, kur pas ankesave është ndryshuar specifikimi teknik për Dializatore qe ka mundesuar pjesëmarrje me te gjere te ofertuesve me prodhues te ndryshëm me çfarë edhe janë lidhur edhe kontrata me çmime shume me te ultë për shërbime te njëjta.

Për te vërtetuar qe AK-SHSKUK nuk i është referuar Listës Esenciale gjate përpunimit te DT ne te njëjtat Lote koeficienti i i Ultrafiltrimit është kërkuar me e madhe ose e barabartë me 40 për Lot 1 dhe me e madhe ose e barabartë me 50 per Lot 3 gje qe nuk eshte ne perputhje me Listen Esenciale ku për produktin qe kërkohet për Lot 1 koeficienti i Ultrafiltrimit është 50 ndërsa për Lot 3 ky koeficient ne LE është 55.

Tutje, Ekspertja Shqyrtuese e lëndës, meqenëse nuk posedon profesionin e cila përkon me natyrën e pretendimeve, atëherë si e tillë, ka kërkuar që të angazhohet eksperti teknik.

Ekspertja teknike pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, sa i përket specifikimeve teknike për LOT 1 dhe LOT 3, ekzistojnë dy vendime të listës esencialetë barnave (LEB):

1. LEB Vendimi i MSH Datë 22/05/23, Nr. Protokolli 05-3113, në tabelën HEMODIALYSES MATERIALS, tek specifikimi llojit CAPILLARY DIALYSER, përveç Steam Sterilization **figuron edhe Gamma Rays (1.6 dhe 1.8).**

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit 01
Nr.Prot: / Broj Prot. / Prot.No 05-3113
Nr.i faqeve / Br.stranica / No.pages -71-
Date: / Datum / Date: 22.01.2023
Prishtinë / a

	CAPILLARY DIALYSERS		High flux polysulfone dialysers - Haemodiafilter, steam sterilization, gamma rays Effective Surface area (m2) 1.6 Ultrafiltration Coeff (ml/h - mmHg) 50 Priming Volume (ml) : 98	
	CAPILLARY DIALYSERS		High flux polysulfone dialysers - Haemodiafilter, steam sterilization, gamma rays Effective Surface area (m2) 1.8 Ultrafiltration Coeff (ml/h - mmHg) 55 Priming Volume (ml) :110	

2. Përderisa, në LEB Vendimi i MSH Datë 21/08/23, **plotësim ndryshim i vendimit,** Nr. Protokolli 05-5106, në tabelën HEMODIALYSES MATERIALS, tek specifikimi llojit CAPILLARY DIALYSER është vetëm Steam Sterilization dmth **është larguar Gamma Rays (1.6 dhe 1.8).**

	CAPILLARY DIALYSERS		High flux polysulfone dialysers - Haemodiafilter, steam sterilization Effective Surface area (m2) 1.6 Ultrafiltration Coeff (ml/h - mmHg) 50 Priming Volume (ml) : 98	
	CAPILLARY DIALYSERS		High flux polysulfone dialysers - Haemodiafilter, steam sterilization Effective Surface area (m2) 1.8 Ultrafiltration Coeff (ml/h - mmHg) 55 Priming Volume (ml) :110	

Po ashtu, vlen të theksohet se specifikat teknike të detyrueshme nga AK për koeficientet e ultrafiltrimit për LOT 1 është kërkuar të jetë më e madhe ose e barabartë se 40, ndërsa për LOT 3 është kërkuar të jetë më e madhe ose e barabartë se 50.

Ku kjo kërkesë për të dy LOT-et 1 dhe 3 bie në kundërshti me LEB, pasi aty koeficienti i ultrafiltrimit për LOT 1 është 50, ndërsa për LOT 3 është 55.

Si përfundim, Vendimi i MSH për LEB, Datë 22/05/23, Nr. Protokolli 05-3113 lejon ekuivalencë /hapësirë për OE; përderisa Vendimi i MSH për LEB, Datë 21/08/23, **plotësim ndryshim i vendimit** Nr. Protokolli 05-5106, kufizon numrin e aplikimeve të OE, andaj përderisa AK tek koeficioenti i ultrafiltrimit lejon ekujvalencë, e cila në LEB është e kufizuar, atëherë si e tillë, konsideroj se edhe pjesa e sterilizimit me avull të lejohet hapsira që të ofrohet edhe me metodat E-Beam Sterilizim, Dry Heat, dhe Gamma, për faktin se e zgjeron konkurrencën dhe respekton nenin 7 të LPP-së.

Si e tillë, sipas sqarimeve më lartë, ekspertja teknike rekomandon që për specifikat teknike për LOT 1 dhe 3 të aprovohet ankesa e OE ankues.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertja shqyrtuese dhe teknike i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Alkaloid**

REPUBLIKA E KOSOVËS
QENDRA E SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Blerina Huruglica

Merita Mehmeti